



INSTITUTI-GOETHE SHKUP

Kushtet e përgjithshme të biznesit – Provimet në Kosovë

1. Parimisht vlejné Rregullorja e Provimeve dhe Rregullat e zbatimit të Institutit-Goethe (www.goethe.de/pruefungen)

- 1.1 Provimet duhet të kalohen të tëra (përjashtim: provimet-B1). Të gjithë pjesëmarrësit e provimeve janë të obliguar, që gjatë paraqitjes së provimit, para provimit me shkrim dhe me gojë, si dhe gjatë tërheqjes së certifikatës, të paraqiten me një pasaportë valide.
- 1.2 Në rast të heqjes dorë nga provimi, si dhe në rastin e largimit nga provimi (shih Rregulloren e provimeve § 12), tarifat e paguara të provimit nuk kthehen.
- 1.3 Nëse pjesëmarrësi/pjesëmarrësja nuk merr pjesë në provimin me shkrim apo me gojë apo paraqitet më vonë në vendin e provimit, atëherë tarifat e paguara të provimit nuk kthehen. Nuk publikohet as rezultati.
- 1.4 Nëse nuk fillohet një provim apo pas fillimit të tij ndërpritet dhe për këtë ekzistojnë arsye shëndetësore valide, atëherë duhet, që brenda 2 ditëve të punës të paraqitet një raport mjekësor prej mjekut ligjor. Vetëm atëherë mund të barten tarifat e provimit në terminin e ardhshëm. Kërkohe një taksë administrative shtesë prej 20 €. Termi i mëtejme jepet në bazë të kapacitetit dhe vendeve të lira në dispozicion në qendrën e provimeve. Nuk ka garancion për një vend në terminin vijues të provimeve.
- 1.5 Për pjesëmarrësit me nevoja të veçanta ekziston mundësia, në bazë të kërkesës, t'i nënshtrihen provimit në kushte të caktuara. Ju lutem informohuni lidhur me këtë para paraqitjes së provimit në qendrën e provimeve.
- 1.6 Në rastin e humbjes së certifikatës brenda 10 viteve mund të lëshohet një vërtëtim zëvendësues. Vërtëtimi është me pagesë. Arkivi i rezultateve të përgjithshme ruhet për 10 vite dhe më pas shkatërrohet me procesverbal.
- 1.7 Telefonat mobil dhe pajisjet tjera regjistruese dhe emituese nuk lejohet të mirren me veti në hapësirën e provimeve. Gjatë pushimeve është gjithashtu e ndaluar të përdoren këto mjete teknike. Në rast të mosrespektimit pason largimi nga provimi.

www.goethe.de

**GOETHE
INSTITUT**

Sprache. Kultur. Deutschland.



2. Paraqitja

- 2.1 Paraqitja bëhet personalisht në zyrën e provimeve. Formularët e regjistrimit duhet të plotësohen me shkronja të mëdha latine. Instituti Goethe Shkup nuk mban përgjegjësi për formularë regjistrimi të plotësuar në mënyrë të parregullt.
- 2.2 Pagesa e tarifës së provimit bëhet sipas të dhënave të emrit të pjesëmarrësit/es dhe të provimeve në SLZ Prishtinë.
- 2.3 Të drejtën e pjesëmarrjes në provime e kanë vetëm ata pjesëmarrës, të cilët janë paraqitur me kohë dhe në mënyrën e duhur. Regjistrimet mund të merren parasysh derisa ka vende të mjaftueshme në dispozicion.

3. Rezultatet dhe certifikatat

- 3.1 Pjesëmarrësit mund t'i kontrollojnë rezultatet e tyre në internet me anë të shifrës së tyre të pjesëmarrjes. Nga Qendra e provimeve nuk jepen informata përmes telefonit lidhur me rezultatet.
- 3.2 Pjesëmarrësit, të cilët e kanë kaluar provimin, marrin certifikatën e tyre në zyrën e provimeve të Institutit-Goethe Shkup në Prishtinë.
- 3.3 Certifikata lëshohet sipas të dhënave gjatë paraqitjes. Pas lëshimit të certifikatës, të dhënat nuk mund të ndryshohen më.
- 3.4 Si shtesë apo zëvendësim i certifikatave modulare nuk lëshohen certifikata të përgjithshme.

Informatat:

Informata të detajuara rreth paraqitjes së provimeve i gjeni në internet www.goethe.de/skopje në rubrikën „Kosovo-Prüfungen“ dhe në zyrën e provimeve të Institutit Goethe Shkup në Prishtinë emaili pruefungen@slzprishtina.org

Instituti-Goethe mban të drejtën për ndryshime. Gjendja: tetor 2017

www.goethe.de

**GOETHE
INSTITUT**

Sprache. Kultur. Deutschland.